

KONTRATË-THMELIMI
E SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
" DAJKO-KOÇI "SH.P.K.



Personat që firmosin më poshtë:

Z. SPIRO DAJKO , i biri i Koços , me shtetësi shqiptare, i datëlindjes 1954, lindur dhe banues në fshatin Shen-Vasi, rrethi Sarandë.

Z. SOTIR KOÇI, i biri ~~Anastasit~~, me shtetësi shqiptare, i datëlindjes 1959 lindur në fshatin Çlirim dhe banues në qytetin e Sarandës.

Z. ANTHULLA ÇAKO, e bija e Vasilit, me shtetësi shqiptare, e datëlindjes 1965, lindur dhe banuese në qytetin e Sarandës.

kanë hartuar si më poshtë vijon kontratën e themelimit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, të cilën janë marrë vesh ta themelojnë në midis tyre.

Shoqëria vepron në bazë të dispozitave ligjore në fuqi si dhe dispozitave të statutit që i bashkëngjitet këtij akti.

Emërtimi i shoqërisë është " DAJKO - KOÇI " SH. P. K.

Objekti i shoqërisë është: Ushtrim të aktivitetit privat në prodhimin e artikujve ushqimorë, pije freskuese, materjale ndertimi, tregtim me shumicë dhe pakicë të artikujve ushqimorë, blektoralë, bujqësorë, industrial pije freskuese, materjale ndertimi, karburante dhe lubrifikante, lëndë të para, import-eksport të të gjithë artikujve, kambizëm, hoteleri, ushqim social, transport mallrash për llogari të shoqërisë dhe të tretëve.

Selia e shoqërisë do të jetë në fshatin Metoq por me kalimin e kohës selia mund të ndryshojë si brenda ashtu edhe jashtë rrethit me përqimin e ortakëve.

Kapitali themeltor i shoqërisë është 100.000 lekë. Ky kapital përbehet nga kontributet e mëposhtme:

Signature

Signature

Signature

Z. SPIRO DAJKO kontribon me shumën prej 33.000 lekë..

Z. SOTIR KOÇI kontribon me shumën prej 33.000 lekë.

Z. ANTHULLA ÇAKO kontribon me shumën prej 34.000 lekë.

Kapitali themeltar i shoqerisë është i ndarë në 100 pjesë, plotësisht të shlyeshme, me vlerë 1000 lekë secila, të renditura sipas numrit të serisë nga 1 deri në numrin e serisë 100.

Në bazë të kontributeve të lartpërmendura:

Z. SPIRO DAJKO merr 33 pjesë të kapitalit themeltar, të renditura nga numri i serisë 1 deri në numrin e serisë 33 për kontributin e tij në para.

Z. SOTIR KOÇI merr 33 pjesë të kapitalit themeltar, të renditura nga numri i serisë 34 deri në numrin e serisë 66 për kontributin e tij në para.

Z. ANTHULLA ÇAKO merr 34 pjesë të kapitalit themeltar, të renditura nga numri i serisë 67 deri në numrin e serisë 100, për kontributin e tij në para.

Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë nënshkruar, shlyer plotësisht dhe janë shpërndarë ndermjet ortakëve si më lartë.

Secili prej ortakëve të ardhëshëm ka derdhur tek Z. ANTHULLA ÇAKO shumën koresponduese të pjesëve të nënshkruara. Shumat e mbledhura prej tij janë depozituar në Degën e Bankës së shtetit Sarandë, në një llogari në emër të shoqerisë në formim e sipër.

Personat që firmosin këtë kontratë, pasi kanë marrë dijeni për derdhjen e fondeve deklarojnë se shumat e derdhura prej tyre janë në përputhje me atë që shenohet në certifikatën e dhenë nga banka dhe se ata konfirmojnë nënshkrimet e pjesëve të kapitalit themeltar në përputhje me shumat respektive të derdhura.

Shoqeria do të administrohet nga një administrator i vetëm. Administratori i parë i emëruar është Z. ANTHULLA ÇAKO me një mandat l-vjeçar dhe me të drejtë rizgjedhjeje.

Z. ANTHULLA ÇAKO i jepen të gjitha kopetencat të cilat ai i pran non për të kryer të gjitha formalitetet e themelimit të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Ai gjithashtu është i autorizuar të veprojë në emër të shoqerisë që krijohet deri në regjistrimin e saj në regjistrin tregtar në Gjykatën e

Spiro

Sotir

Anthulla

Tiranës, veçanërishtë ai është i pajisur me mandat për të kryer akte dhe për të marrë angazhime në emër të shoqërisë, të cilat i kalojnë shoqërisë që nga momenti i regjistrimit.

Perveç të tjerave administratori është i ngarkuar për të kryer akte dhe marrë angazhime që janë në përputhje me objektin e shoqërisë dhe kompetencat e tij. Pasi të behet regjistrimi i shoqërisë, këto akte dhe angazhime që janë në përputhje me objektin e shoqërisë i nënshtrohen miratimit të bashkësisë së ortakëve, jo më vonë se nga data e mbledhjes së Asamblesë që shqyrton dhe vendos mbi llogaritë e vitit të parë financiar.

Ky miratim bën automatikishtë kalimin e këtyre akteve dhe angazhimeve në favor të shoqërisë (ngarkim).

Kjo kontratë themeluese është hartuar në Sarandë me datën 1/09/1995 në katër ekzemplarë, në gjuhën shqipe, duke pasur të gjitha fuqinë të barabartë ligjore. Një kopje dorëzohet në Gjykatën e Tiranës ku behet edhe regjistrimi, kopja e dytë lihet në zyrën noterjale, kopja tjetër jipet në zyrën e tatimeve dhe kopja e fundit mbahet nga vetë ortakët.


SPIRO DAJKO



SOTIR KOÇI



ANTHULLA ÇAKO



REPUBLIKA E SHQIPERISË
N O T E R I A

Nr. 1408 Rep.
Nr. 428 Kol.

V E R T E T I M

Sot me datën 1/09/1995 u paraqitën personalishtë para meje noteres Ermioni Gjoka shtetasit Spiro Dajko, Sotir Koçi dhe Anthulla Çako, ortak të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "DAJKO-KOÇI", me seli në fshatin Metoq, madhorë dhe me zotësi të plotë juridike, për identitetin e së cilës u sigurova nga letërnjoftimet e tyre personale, të cilët më deklaruan se sa më sipër është haruar me dëshirën e tyre dhe nënshkruan para meje konformë ligjit.

Unë mbasi i gjeta në rregull i vertetoj sipas ligjit.

N O T E R E

ERMIONI GJOKA



STATUT

I SHOQERISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

" DAJKO-KOÇI " SH.P.K.

Personat që firmosin më poshtë:

Z. SPIRO DAJKO , i biri i Koços , me shtetësi shqiptare, i datëlindjes 1954 lindur

Z. SOTIR KOÇI , i biri Anastasit, me shtetësi shqiptare, i datëlindjes 1959, lindur në fshatin Çlirim dhe banues në Sarandë.

Z. ANTHULLA ÇAKO , me shtetësi shqiptare, e bija e Vasilit, e datëlindjes 1965, lindur dhe banuese në qytetin e Sarandës.

kanë hartuar si më poshtë vijon statutin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar të cilën janë marrë vesh ta themelojnë midis tyre.

KREU I

FORMA, EMËRTIMI I SHOQERISE, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA.

Neni 1

Forma.

Ndermjet firmuesve të aktit themeltar është krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me dispozitat e këtij statuti.

Neni 2

Emërtimi i shoqërisë.

Emri i shoqërisë është " DAJKO - KOÇI " SH. P. K.

Neni 3

Objekti i shoqërisë.

Objekti i shoqërisë është: Ushtrim të aktivitetit privat në tregtimin

4

e artikujve ushqimorë, pije freskuese, materjale ndertimi, tregtim me shumicë dhe pakicë të artikujve ushqimorë, blektoralë, bujqësorë, industrialë, pije freskuese, materjale ndertimi, karburante dhe lubrifikante, lëndë të para, import-eksport të të gjithë artikujve, kambizëm, hoteleri, ushqim social, transport mallrash për llogari të shoqërisë dhe të tretëve.

Neni 4

Selia e shoqërisë.

Selia e shoqërisë fillimishtë do të jetë në fshatin Metoq të rrethi Sarandë.

Transferimi i selisë së shoqërisë në një adresë tjetër bëhet me miratimin e shumicës së ortakëve që zotërojnë mbi 3/4 e kapitalit themeltar.

Neni 5

Kohëzgjatja.

Kohëzgjatja e shoqërisë është përcaktuar për një periudhë prej 20 vjetësh duke filluar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

Kjo periudhë mund të zgjatet tej këtij afati ose të shkurtohet kur shoqëria prishet para kohe.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESËT E KAPITALIT THEMELTAR.

Neni 6

Kapitali themeltar.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë.

Ai është i ndarë në 100 pjesë, me vlerë 1000 leke secila, të renditura nga numri i serisë 1 deri në numrin e serisë 100 krejtësishtë të shlyera.

Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar nëpërmjet shtimit të pjesëve të reja, ortakët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrim, proporcionalishtë me shumën e pjesëve të tyre.

Solaj

5 *Skor*

Ante



Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e saj. Zvogëlimi i kapitalit vendoset nga Asamblea e ortakëve me shumicën e ortakëve të pranishëm, ose të përfaqësuar që zotërojnë mbi 3/4 e kapitalit themeltar.

Zvogëlimi i kapitalit i prek të gjithë ortakët në të njëjtën masë.

Neni 7

Kontributet

Kapitali themeltar përbehet nga kontributet e mëposhtme:

Z . SPIRO DAJKO kontribon me shumën prej 33.000 lekë.

Z .SOTIR KOÇI kontribon me shumën prej 33.000 lekë.

Z .ANTHULLA ÇAKO kontribon me shumën prej 34.000 lekë.

Neni 8

Pjesët e kapitalit themeltar.

Në bazë të kontributeve të lartëpërmendura:

Z . SPIRO DAJKO merr 33 pjesë të kapitalit themeltar, të renditura nga numri i serisë 1 deri në numrin e serisë 33 për kontributit e tij në para.

Z .SOTIR KOÇI merr 33 pjesë të kapitalit themeltar, të renditura nga numri i serisë 34 deri në numrin e serisë 66, për kontributin e tij në para.

Z .ANTHULLA ÇAKO merr 34 pjesë të kapitalit themeltar të renditura nga numri i serisë 67 deri në numrin e serisë 100 për kontributin e saj në para.

Të gjitha pjesët që formojnë kapitalin themeltar, nënshkruhen, shlyhen plotësisht, pastaj shpërndahen midis ortakëve sipas ndarjes së mësipërme.


Neni 9

Lenia dhe transferimi i pjesëve të kapitalit

Pjesët e kapitalit janë lirishtë të transferueshme ndërmjet ortakëve në rrugë trashëgimie, në rast ndarjeje pasurore në mes bashkëshortëve dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen të tretëve vetëm me miratimin e ortakëve që zotërojnë mbi 3/4 e pjesëve të kësaj kushte jo më të favorshme se ato me të cilat u janë afruar më parë ortakëve të tjerë.



6 



KREU III

MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQËRISË



Neni 10

Ortakët dhe asamblea e ortakëve

Ortakët e shoqërisë përballojnë humbjet e saj deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e Asamblesë dhe disponon një numër votash të barabarta me pjesët e kapitalit themeltar që ai zotëron. Në ushtrimin e të drejtës së tyre për të marrë pjesë në vendimet kolektive, çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një ortak tjetër, nga bashkëshorti ose nga një person tjetër i zgjedhur prej tij.

Mbledhja e Asamblesë së ortakëve mund të thirret nga një ose disa ortakë që zotërojnë 1/10 e pjesëve të kapitalit themeltar, nga administratori, nga ekspertët kontabël të autorizuar ose nga likuidatorët.

Sipas rendësisë së vendimeve, mbledhja e Asamblesë mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme. Asamblea e zakonshme vendos për çeshtje të tilla si, emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likuiduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe kontrollit, miratimi i llogarive vjetore dhe ndarjes së fitimit e tjera. Asamblea e jashtëzakonshme vendos për çeshtje të tilla si ndryshimet e statutit, zvogëlimi i kapitalit themeltar, transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët, zgjatje e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shdërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera e tj.

Asamblea e zakonshme në mbledhjen e parë mund të marrë vendime të vlefshme në qoftë se janë të pranishëm ose të përfaqësuar një numër ortakësh që zotërojnë mbi 1/2 e pjesëve të kapitalit themeltar dhe vendimet merren me miratimin e ortakëve që zotërojnë 1/2 e kapitalit themeltar. Në qoftë se mbledhja e parë e Asamblesë së zakonshme nuk realizohet, thirret mbledhja e dytë e cila mund të marrë vendime të vlefshme, pamvarësisht se sa pjesë të kapitalit themeltar zotërojnë ortakët e pranishëm ose të përfaqësuar dhe vendimet merren me një shumicë votash të mbi 1/2 të ortakëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

Asamblea e jashtëzakonshme kërkon kushte prezence ose përfaqësimi të njejta me ato të Asamblesë së zakonshme si në mbledhjen e parë ashtu edhe në mbledhje e dytë, por ajo merr vendime me miratimin e ortakëve të pranishëm ose të përfaqësuar që zotërojnë 3/4 e kapitalit.

Neni 11
Administrimi

Shoqeria administrohet nga një administrator qe duhet të jetë person fizik dhe mund të jetë ortakë në shoqeri ose jo.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me miratimin e shumicës së, ortakëve që Zotërojnë mbi 1/2 e pjesëve të kapitalit themeltar. Emërimi i tij behët për një kohëzgjatje prej 1-vjetësh financjar me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm.

Në marrëdhënjet me ortakët dhe të tretët administratori i ka të gjitha kopetencat për të kryer të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë dhe në emër të tij, nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e shoqërisë, me përjashtim të atyre rasteve që ligji dhe ky statut ja japin shprehimisht ortakëve.

Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, qoftë për shkelje ligjore, qoftë për shkelje të statutit ose për faje të kryera gjatë administrimit të tij.

Administratori ka të drejtë ti delegojë nëpërmjet një akti me shkrim

Neni 12

Ekspertët kontabël të autorizuar

Kontrolli i shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar, i emëruar për tre vite financjare me mundësi rizgjedhjeje nga ortakët që përfaqësojnë mbi 1/2 e kapitalit themeltar.

Shkarkimi i ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kondita si emërimi, në rast se vrehen gabime ose behët e pamundur kryerja e detyrës.

KREU IV

VITI FINANCJARË, LLOGARITË VJETORE, NDARJA E FITIMEVE

Neni 13

Viti financjarë, llogaritë vjetore

Çdo vit financjar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimishtë, viti i parë financjarë do të përfundojë me 31 DHJETOR 1995.

Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financjarë dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratorët dhe eventualishtë nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga Asamblea me vendim të Ortakëve që zotërojnë mbi 1/2 e pjesëve të kapitalit

Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore behën brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiarë.

Neni 14

Dividentët

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, Asamblea e ortakëve përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e dividendeve mbi fitimin. Fitimi, që do të ndahet ndermjet ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar, përbehet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna menjatë për fondin rezervë të domosdoshëm (5% e fitimit të çdo viti, deri sa ky fond të arrijë vlerën e 1/10 e kapitalit themeltar) dhe nga ana tjetër i janë zbritur ose i janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

KREU V

ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Neni 15

Zgjatja e afatit

Me përfundimin e afatit të përcaktuar në nenin 5 të këtij statuti, Zgjatja e tij mund të vendoset nga Asamblea me miratim të ortakëve që zotërojnë mbi 3/4 e pjesëve të kapitalit themeltar.

Neni 16

Prishja

Shoqëria priset me përfundimin e afatit të përcaktuar në nenin 5 të këtij statuti, me përjashtim të rasteve ku behët zgjatja e afatit sipas nenit 15 të këtij statuti, ose kur ka një prishje të parakohshme për arsyet e parashikuara në ligj.

Shoqëria nuk priset kur njëri prej ortakëve falimenton, behët i paaftë ose vdes.

Neni 17

Likujdimi

Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi Asamblea emëron një ose disa likujdues të cilët i paraqesin asaj raportin rapotin mbi gjendjen e aktivitetit dhe

9

pasivit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

Në fund të procesit të likuidimit Asamblea vendos, me miratim të organeve që zotërojnë mbi 3/4 të pjesëve të kapitalit themeltar, mbi bilancin përfundimtar financiar, mbi aktin e rregullueshmërisë së punës së likuiduesit dhe mbi mbylljen e procesit të likuidimit.

Mbas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së pjesëve të kapitalit themeltar tek kontribuesit përkatës, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura ndërmjet ortakëve proporcionalisht, me pjesët që ata zotërojnë në kapitalin themeltar.

KREU VI

DISPOZIATA TË FUNDIT

Neni 18

Shdërrimi i shoqërisë

Shdërimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri kolektive ose në shoqëri komandite mund të kryhet vetëm me miratimin unanimit të ortakëve, ndërsa shdërimi në shoqëri anonime, me miratimin e ortakëve që zotërojnë mbi 3/4 e pjesëve të kapitalit themeltar.

Neni 19

Mosmarrveshjet

Të gjitha mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë, do të paraqiten për zgjidhje gjykatave kompetente shqiptare.

Neni 20

Ky statut është hartuar në datë 1/09/1995, në Sarandë, në 4 ekzemplarë origjinalë në gjuhën shqipe duke patur të gjithë tekstet fuqi të njëjtë ligjore. Një kopje dorëzohet në Gjykatën e rrethit të Tiranës, një kopje tjetër lihet në zyrën noteriale, kopja e tretë dorëzohet në degën e tatimeve dhe kopja e katërt mbahet nga vetë ortakët e shoqërisë.


O R T A K Ë T

SPIRO DAKO

SOTIR

KOÇI

ANTHULLA ÇAKO



10

